



RAPORTI VETËVLERËSIMIT

UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

2022-2023

VETËVLERËSIMI PËRGJATË VITIT AKADEMIK 2022-2023

Realizimi

Raporti i Vetëvlerësimit paraqet një studim të funksionimit institucional të UAMD-së dhe përmbushjen e standardeve të cilësisë për vitin akademik 2022-2023. Raporti është hartuar duke u bazuar në 5 fushat e vlerësimit:

1. Organizimi dhe Menaxhimi
2. Burimet
3. Kurrikula
4. Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi
5. Studentët dhe Mbështetja e tyre

Ky raport përmbledh evidencat me anë të së cilave vlerësohet përmbushja e standardeve të cilësisë të veprimtarive akademike dhe mësimore dhe mundëson analizimin e nevojave dhe vendosjen e objektivave për zhvillimin e cilësisë.¹

Qëllimi

Vetëvlerësimi ka si qëllim prezantimin e punës të organizuar brenda një viti akademik në Universitetin ‘Aleksandër Moisiu’ Durrës, prezantim ky që hartohet në kuadër të procesit të Akreditimit Institucional dhe akreditimit të programeve të studimit që ofrohen pranë IAL-së.

Qëllimi i këtij vlerësimi është inkurajimi i IAL-së që të punojnë për rritjen e vazhdueshme dhe sistematike të cilësisë së ofertës akademike dhe përmirësimin e kushteve të mësimdhënies dhe mësimnxënies të studentët. Në kuadër të këtij misioni, ky raport synon të japë informacion mbi objektivat, procedurat dhe pritshmëritë e këtij procesi vlerësimi, përfshirë ato që lidhen me pikat e referencës së gjykimit, mbledhjen e të dhënave, grupet e vlerësimit të jashtëm dhe vetë procesin e vlerësimit.

RVB shërben njëkohësisht edhe për të rikonceptuar strategjinë, objektivat, vizionin dhe misionin e universitetit me synimin për të ngritur në një nivel gjithnjë e më të lartë shkallën e performancës dhe efektivitetin e punës për të garantuar vazhdimësinë e sigurimit të cilësisë.

¹Rregullorja e Sistemit të Brëndshëm të Sigurimit të Cilësisë (Dokument i)

Vetëvlerësimi në UAMD

Në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës sigurimi i cilësisë është një prioritet.

Gjatë vitit akademik 2021-2022 aplikua për akreditimin insitucional i cili mori vlerësim POZITIV duke u akredituar me vlerësim të lartë me kohëzgjatje 4 (vite) akademike. Zgjerimi me programe të reja pasqyron më së miri azhornimin e vazhdueshëm me kërkesat e tregut të punës kombëtare dhe ndërkombëtare.

Gjatë vitit akademik 2021-2022 aplikua për akreditimin e disa programeve studimi, ndër të cilat këtë vit morëm vlerësime pozitive për programet sipas tabelës së mëposhtme, gjithashtu mbetemi në pritje të përgjigjeve rreth pjesës së mbetur të programeve,

Bachelor në “Bankë- Financë”	Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr.12 datë 12.01.2024- Vlerësimi- (POZITIV) Akreditohet për 5 vite//Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është 11.01.2029.
Bachelor në “Komunikim dhe Marketing Digjital”	Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr.16 datë 12.01.2024 -Vlerësimi- (POZITIV) Akreditohet për 5 vite//Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është 11.01.2029.
Bachelor në “Financë-Kontabilitet”,	Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr.13 datë 12.01.2024 -Vlerësimi- (POZITIV) Akreditohet për 5 vite//Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është 11.01.2029.
Master i Shkencave në “Financë-Kontabilitet”,	Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr.14 datë 12.01.2024 -Vlerësimi- (POZITIV) Akreditohet për 3 vite//Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është 11.01.2027.
Mater i Shkencave në “Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut	Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr.15 datë 12.01.2024 -Vlerësimi- (POZITIV) Akreditohet për 3 vite//Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është 11.01.2027.
2-vjeçar, me karakter profesional në “Hidroteknikë, Ujësjellës Kanalizime”	Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr.21 datë 12.01.2024- Vlerësimi- (POZITIV) Akreditohet për 4 vite//Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është 11.01.2028.
2-vjeçar, me karakter profesional në “Teknologji Automobilash”	Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr.19 datë 12.01.2024- Vlerësimi- (POZITIV) Akreditohet për 4 vite//Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është 11.01.2028.
2-vjeçar, me karakter profesional në “Menaxhim Ndërtimi”	Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr.18 datë 12.01.2024 -Vlerësimi- (POZITIV) Akreditohet për 4 vite//Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është 11.01.2028.
Bachelor në "Fizioterapi"	Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 56, datë 15.03.2024 -Vlerësimi- (POZITIV) Akreditohet për 3 vite//Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është 14.03.2027.
Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme"	Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 57, datë 15.03.2024 -Vlerësimi- (POZITIV) Akreditohet për 4 vite//Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është 14.03.2028.
Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale"	Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 58, datë 15.03.2024 -Vlerësimi- (POZITIV) Akreditohet për 5 vite//Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është 14.03.2029.
2-vjeçar, me karakter profesional në “Asistent Ligjor”	Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 60, datë 15.03.2024 -Vlerësimi- (POZITIV) Akreditohet për 5 vite//Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është 14.03.2029.
Bachelor në “Multimedia dhe Televizion Digjital”	Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr.38 datë 13.01.2024 -Vlerësimi- (POZITIV) Akreditohet për 5 vite//Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është 12.01.2029.
2-vjeçar, me karakter profesional në “Specialist Pajisjesh Elektronike”	Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr.22 datë 12.01.2024 -Vlerësimi- (POZITIV) Akreditohet për katër vite//Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është 11.01.2028.
2-vjeçar, me karakter profesional në “Aplikacion Web dhe Dizajnim Grafik”	Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr.17 datë 12.01.2024 -Vlerësimi- (POZITIV) Akreditohet për 5 vite//Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është 11.01.2029.
Bachelor në "Arsim Fillor"	Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 61, datë 15.03.2024 -Vlerësimi- (POZITIV) Akreditohet për 5 vite//Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është 14.03.2029.
Master Profesional në "Didaktikë"	Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 59, datë 15.03.2024 -Vlerësimi- (POZITIV) Akreditohet për 5 vite//Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është 14.03.2029.

Përgjatë vitit akademik 2022-2023 kemi aplikuar për akreditimin e programeve të studimit poshtëshënuar:

Fakulteti i Edukimit:

1. Diplomë Profesionale në “Edukator për moshën 0-3 vjeçare”
2. Diplomë Profesionale në “Kujdestar për moshën e tretë”
3. Bachelor në “Filozofi- Sociologji”
4. Mater Profesional në “Mësues i Gjuhës Gjermane”
5. Master i Shkencave në “Edukim në Vazhdim”

Fakulteti i Biznesit:

- 1. Diplomë Profesionale në “Guidë Turistike”**
- 2 Bachelor në “Shkenca Ekonomike”**
- 3. Bachelor në “Turizëm”**
- 4. Mater Profesional në “Drejtım i SME-ve”**
- 5. Mater Profesional në “Bankë-Financë”**
- 6. Mater Profesional në “Menaxhim Biznes”**
- 7. Mater Profesional në “Menaxhim i Sipërmarrjeve Turistike”**
- 8. Master i Shkencave në “Ekonomi Biznes”**
- 9. Doktoratë në “Shkenca Ekonomike”**

Fakulteti i Shkencave Politike Juridike:

- 1. Master Profesional në “Politika dhe Administrim” me profil “Administrim Financiar”**
- 2. Master I Shkencave në “E drejtë private”**

HISTORIKU I UNIVERSITETIT

“ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës është një institucion publik i arsimit të lartë i krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Nr. 801, datë 20.12.2005 “Për hapjen e Universitetit “Aleksandër Moisiu” në Durrës.

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës (në vijim UAMD) i hapi dyert për herë të parë në vitin akademik 2006-2007, me rekrutimin e rreth një mijë studentë nga pothuajse të gjitha trevat e vendit. Fillimisht universiteti ishte i përbërë nga tri njësi kryesore, si më poshtë:

- 1- Fakulteti i Edukimit
- 2- Fakulteti i Ekonomisë dhe Administrimit
- 3- Shkolla e Lartë Profesionale.

Me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 685, datë 25.08.2010 “Për riorganizimin e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, në fillim të vitit të ri akademik 2010-2011, universiteti u zgjerua dhe medhy fakultete të reja, Fakultetin e Shkencave Politike-Juridike dhe Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit. Gjithashtu, u riorganizuan njësitë kryesore të universitetit duke bërë të mundur që sot në përbërje të tij të jenë 5 fakultete si Fakulteti i Biznesit, Fakulteti i Edukimit, i Teknologjisë së Informacionit, Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike, Fakulteti i Studimeve Profesionale, si dhe filiali në qytetin e Peshkopisë, të organizuar në pesë njësi kryesore, si më poshtë:

- 1- Fakulteti i Biznesit;
- 2- Fakulteti i Shkencave Politike Juridike;
- 3- Fakulteti i Edukimit;
- 4- Fakulteti i Studimeve Profesionale;
- 5- Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit;

Fakulteti i Studimeve Profesionale funksionon bazuar në filozofinë me të ashtuquajtuara “community college” (kolegje komunitare) nga eksperiencia e vendeve anglo-saksone, ofron diploma të fokusuara më së shumti në profesione praktike të kërkuara dhe frymëzuar nga tregu i punës. Aktualisht Fakulteti i Studimeve të Integruara me praktikën ka kaluar si njësi bazë pranë Fakultetit të Studimeve Profesionale me urdhër nr. 110 datë 25.05.2021 të MASR. Përgjatë vitit akademik 2022-2023 është shtuar pranë Fakultetit të Biznesit, Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar.



ORGANIZIMI I INSTITUCIONIT

Baza ligjore dhe Autonomia në organizimin e brendshëm

Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës është krijuar me VKM Nr. 801, dt 20.12.2005 “Për hapjen e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës”, si një Institucion Publik i Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor. Universiteti ka një statut të miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës në Maj të vitit 2011. Ai mbështetet në Ligjin Nr. 80, dt 22.07.2015, (në vijim LAL) në aktet nënligjore të bazuara në të, sidhe legjislacionin ekzistues në fuqi. Statuti është në përputhje të plotë me misionin dhe qëllimet e universitetit, sipas të cilave UAMD të gjithë veprimtarinë e tij synon në mënyrë të vazhdueshme të arrijë standardet akademike më të larta bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe të përkrahë aspiratat arsimore dhe arritjet e cilitdo që kërkon të përfitojë nga arsimi i lartë. Statuti i nënshtrohen të gjitha njësitë dhe strukturat organizative dhe mësimore shkencore të Universitetit.

Institucioni disponon rregulloren e tij të brendshme, e cila ka për qëllim rregullimin e veprimtarisë mësimore-shkencore dhe administrative të Universitetit në përputhje me objektivat dhe misionin ligjor të tij. Ajo i shtrin efektet e saj në të gjitha strukturat, organet dhe autoritetet drejtuese, njësitë përbërëse, personelin akademik, personelin ndihmës mësimor-shkencor, personelin administrativ, studentët, etj.

Në rishikimin dhe përmirësimin e rregullores përfshihen aktorë të ndryshëm institucionalë nga njësitë respektive, por edhe përfaqësuesit e studentëve. Mënyra se si bëhet përmirësimi dhe rishikimi i kuadrit rregulator brenda UAMD është një indikator pozitiv për mirëfunksionimin institucional.

Strukturat administrative dhe akademike sigurojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë menaxheriale dhe akademike të Universitetit. Organet kolegjiale të zgjedhura funksionojnë, sipas statutit dhe mundësojnë diskutimet, debatet dhe marrjen e vendimeve në formë gjithëpërfshirëse. Institucioni e kryen rregullisht procesin e informimit publik përmes faqes zyrtare të internetit, si dhe raportit vjetor, i cili pasqyron gjerësisht veprimtarinë akademiko-shkencore dhe administrative të tij i cili bëhet publik çdo fundviti, sipas Udhëzimit të Ministrit Përgjegjës të Arsimit, brenda afateve të caktuara dhe strukturës që duhet të përmbajë raportin.

UAMD bashkëpunon me organizma të tjerë nga sektori publik dhe ai privat në mbështetje të studentëve për praktikën e tyre mësimore. UAMD është pjesë e programeve të mobilitetit të studentëve dhe stafit në kuadër të partneriteteve ndërkombëtare, Institucioni ka Planin e Zhvillimit Strategjik afatgjatë me objektiva dhe tregues të qartë mbi të cilin mbështeten politikat e përmirësimit të cilësisë.

Institucioni është bazuar gjithashtu në Planin e Zhvillimit Strategjik për periudhën 2020 – 2025 .

Plani përcakton qartë objektivat e synuar, strategjitë për arritjen e tyre si dhe treguesit e performancës. Pjesa më e madhe e rezultateve të performancës dhe objektivave të strategjisë pasqyrohen gjatë diskutimeve dhe publikimit të Raportit Vjetor mbi Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore dhe financiare të Institucionit çdo fundviti me drejtuesve të institucionit, stafin akademik, studentëve dhe të ftuarve të tjerë të jashtëm.⁴

Plani i Zhvillimit për periudhën 2020-2025, vë në dukje ato tematika që kanë nevojë të rishikohen,

²V.K.M. Nr. 801, datë 20 dhjetor 2005

³Rregullorja e UAMD

⁴Planin e Zhvillimit Strategjik për periudhën 2020 – 2025

duke analizuar së pari arritjet e deritanishme, çështjet e parealizuara, si dhe duke e diskutuar në tryeza të rrumbullakëta me aktorët përkatës siç edhe është shndërruar në një praktikë shumë pozitive në UAMD.

Ajo do të përshtatet me sfidat aktuale në fushën e arsimit të lartë, legjislacionin e ri, si dhendryshimet në mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm të Institucioneve të Arsimit të Lartë.

Për të përmbushur detyrimet e ndryshme administrative UAMD, bazuar në organigramën e saj, është e organizuar në drejtori, sektorë dhe degë, kurse nga aspekti akademik në Njësi Kryesore dhe Njësi Bazë. Gjithashtu ekzistojnë edhe njësi të tjera ndihmëse me karakter akademik dhe karakter administrativ, të cilat veprojnë në nivel Rektorati dhe Njesie Kryesore. Pranë Rektorit, kryejnë një rol të rëndësishëm administrativ edhe tre zëvendësrektorë, të cilët janë përgjegjës përkatësisht për: kërkimin shkencor, fushën mësimore dhe atë institucionale.

Përfaqësimi i studentëve në Senat Akademik dhe në organe të tjera kolegjale të zgjedhura garantohej në çdo rast dhe pjesëmarrja është dinjitoze dhe frytdhënëse. Institucionit ka ngritur edheqendra me karakter mësimor-shkencor dhe kërkimor:

- Qendra për Zhvillim dhe Ekselencë (QZHE);
- Qendra për Edukimin në Vazhdim (QEV)
- Qendra e Trashëgimisë Kulturore Mesjetare (QTKM)

QZHE funksionon si një strukturë që përfshin të gjitha njësitë kryesore dhe bazë të fakulteteve. Qëllimi i saj është nxitja, mbështetja, organizimi, koordinimi, monitorimi dhe vlerësimi i veprimtarisë për kërkimin shkencor, ekselencë dhe zhvillim. Qendra është përgjegjëse për botimin e revistës shkencore të Universitetit “ Interdisciplinary Journal of Research and Development” e lancuar për herëtë parë në vitin 2013.

QEV është njësi bazë e veçantë në strukturën akademike të UAMD në varësi të Fakultetit të Edukimit dhe funksionon në bazë të rregullores së brendshme të saj. Aktivitetet kryesore të cilat zhvillohen përmes kësaj qendre janë trajnimet e mësuesve të arsimit parauniversitar sipas foramtit të përcaktuar nga MAS. QEV funksionon si qendër kërkimore dhe e publikimeve të studimeve shkencore në fushën e edukimit.

QTKM është një qendër kërkimore-shkencore pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu” në Durrës. Qendra është krijuar me vendim nr .15, 13.10.2016 të Këshillit të Administrimit, UAMD. Qendra nëpërmjet kombinimit të disa drejtimeve si arkeologjia dhe historia, trashëgimia materiale dheshpirtërore, por edhe turizmi kulturor dhe historia e artit, përpiqet të kërkojë, organizojë projekte, publikojë rezultatet dhe të kthehet në një hapësirë të shkëmbimit të mendimeve midis fakulteteve të ndryshme të universitetit. Sigurisht që Qendra synon që të ndërveprojë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar me qëllim arritjen e bashkëpunimeve në avancimin e studimit të vlerave dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore.

QENDRA PËR ZHVILLIMIN E TRASHËGIMISË ANTIKO MESJETARE SHQIPTARE



Dr. Ols Lafe , Drejtor i Qendrës për Zhvillimin e Trashëgimisë Antiko Mesjetare Shqiptare , i ftuar nga Departamenti i Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në bashkëpunim me programin International Visitor Leadership Program (IVLP) dhe organizatën Gulf Coast Diplomacy , zhvilloi një bisedë me grupimin e Diplomateve të Rinj të shtetit të Florida - s . Dr. Lafe si një pjesëmarrës gjatë vitit 2012 në programin IVLP dhe Qytetar Nderi i Pensacola (Florida) , për shkak të kufizimit të udhëtimevendërkombëtare zhvilloi online një bisedë të hapur dhe me shumë ilustrime , me fokus Shqipërinë dhe arkeologjinë e saj , por edhe turizmin , gjuhën dhe diversitetin kulturor . Pyetjet e të rinjve të cilët më përpara kishin informacione vetëm gjeografike për Shqipërinë , u përqëndruan në prezantimin e potencialit arkeologjik dhe turistik të vendit por edhe për të ardhmen Europiane të saj.

Gjatë vitit akademik 2022-2023, QZHTAMSH ka vijuar aktivitetin shkencor dhe kontaktet me universitete e qendra të kërkimore-shkencore në vendet e BE dhe USA për të realizuar marrëveshje kuadër me UAMD të cilat më pas mund të aktivizohen specifikisht nëpërmjet projekteve kërkimore-shkencore në varësi të hapësirave të aplikimeve për fonde nga burime të tjera.

Më konkretisht, QZHTAMSH nëpërmjet komunikimit e vazhdueshëm dhe mbështetjen e Rektoratit ka arritur të punojë me partnerët për arritjen e firmosjes së disa marrëveshjeve, organizimin e aktivitetit kërkimor-shkencor në terren si dhe pjesëmarrjen në konferenca kombëtare e ndërkombëtare e leksione të hapura si vijon:

A. Marrëveshje bashkëpunimi

1. Marrëveshje bashkëpunimi mes UAMD dhe Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Vlorë (12.10.2022)
2. Marrëveshje bashkëpunimi mes UAMD dhe University of Michigan (USA) për kërkime të përbashkëta arkeologjike (7.6.2023)

B. Projekte

1. Vijon projekti kërkimor-shkencor “Varret shkëmbore të Matit” dhe territori i tyre - studime arkeologjike në pellgun ujëmbledhës të lumit të Matit (miratuar në Ministrinë e Kulturës, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, Vendim nr.104 datë 19.4.2022). Të dhënat e reja në proces përpunimi janë fokusuar në arkitekturën e varreve shkëmbore dhe në pozicionimin me GPS të tumave të gërmuara përpara vitit 1990.

C. Botime

2. **Lafe. O.**, Tota, U., Gjuraj, Gj., Mazari, R. Raport i gërmimit arkeologjik të shpëtimit në zonën arkeologjike B të Parkut të Finiqit, in CANDAVIA 9, 2022, p. 271-276, Akademia e Studimeve Albanologjike
3. **Lafe, O.**, Xheka, E. Raport mbi gjetjen e një fragmenti kolektori në lagjen Goricë (Berat), në Revista Arkeologjike 1, 2022, p.55-60, Ministria e Kulturës

D. Prezantime në konferenca kombëtare e ndërkombëtare, leksione të hapura

2022 The rock-cut tombs of Mat river valley in Albania: preliminary results from the 2022 field season, in the International Conference on "Archaeology of the Balkans. From Prehistory to the End of Antiquity, Recent Discoveries and New Methods", 17-19 November 2022, Prishtina, Kosova.

2022 Rescue Archaeology / Heritage Management in Albania. Presented at University of Cincinnati, Ohio, USA, November 2, 2022.

2022 Cultural Landscape and Preventive Archaeology in Albania: The Cultural Heritage Law of 2018 and the Impact of Legislation in the Management of Archaeological Resources, in the 7th International Landscape Archaeology Conference 10-15 September 2022 Iași - Suceava, Romania (book of abstracts pg.190-191).

2022 "Urban archaeology in Durrës (Albania)-problems and the future". Presented at the 10th annual meeting of Dutch Urban Archaeology, October 5, 2022.

2022 Urban archaeology in Durrës (Albania)-problems and the future, in the 28th European Association of Archaeologists Annual Meeting, Budapest, Hungary 31 August-September 2022 (abstract book pg.495).

QENDRA PËR EDUKIM NË VAZHDIM

Qendra për Edukim në Vazhdim është një prej gjashtë njësive bazë të Fakultetit të Edukimit. QEV është njësia bazë më e re në Fakultetin e Edukimit. Ajo në vitin akademik 2017 – 2018 plotëson të gjitha kriteret e parashikuara në Nenin 26 të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe të Statutit të UAMD.

Në vëmendjen e anëtarëve të QEV është puna intensive dhe e përgjegjshme në drejtim të kujdesit ndaj studentit dhe krijimin e mundësive të tyre për të marrë informacionin e duhur dhe krijimit të mundësive për të shprehur talentet, idetë dhe fjalën e tyre të lirë.

Gjatë vitit akademik 2022-2023 QEV zhvilloi veprimtarite në përputhje me planin vjetor të miratuar në dekanatin e FE, ku do të veçojmë:

- Më datë 02 dhjetor 2022, në ambjentet e bibliotekës së FE u organizua promovimi i librit “Komunikimi më i ri në sociologjinë politike” me autor Dr. Faton Murseli, pedagog në Universitetin e Tetovës. U diskutua mbi shumë llojshmërinë e dimensionit mediatik, komunikimet hibride dhe qasjet më të reja brenda komunikimit politik. Ky aktivitet promovues u zhvillua në bashkëpunim me Departamentin e Sociologjisë.
- Më 22 dhjetor 2022, studentët e programeve profesionale “Edukator për moshën 0-3 vjeç” dhe “Kujdestar për moshën e tretë” organizuan festën e fundvitit me fëmijët e Shtëpisë së Foshnjes Nr.1 në Durrës. Gjithashtu me kontributin e studentëve u shtrua dhe një drekë festive në Qendrën e të Moshuarve pranë Kryqit të Kuq Durrës.
- Vizitë mësimore në Qytetin e Shkodrës me 25 janar 2023, në kuadër të përfundimit të kursit Edukimi Etnokulturor me studentët e programeve profesionale “Edukator për moshën 0-3 vjeç” dhe “Kujdestar për moshën e tretë”. Në fokus të kësaj vizite ishte Biblioteka “Gjergj Fishta” në Urdhrin e Françeskanëve në Gjuhadol dhe Muzeu Kombëtar i Fotografisë “Marubi”
- Orë e hapur nën ligjërimin e Dr. Natasha Poroçanit “Autorja e vitit 2022 në letërsinë për fëmijë”. Ky aktivitet u zhvillua më 26 janar 2023 në ambjentet e bibliotekës së FE, në kuadër të kursit Krijimi i shkathtësive tek fëmijët nëpërmjet të lexuarit.
- Më datë 19-20 prill 2023, në kuadër të projektit Erasmus + Entral, u zhvillua trajnimi për stafin akademik të UAMD me temë “Drejt një mendësie sipërmarrëse”.
- Më datë 12 maj 2023, u zhvillua aktiviteti i Forumit të Mësuesve. Punimet e mësuesve u botuan në librin e punimeve “Arsimi në shekullin XXI”. U realizua prezantimi i punimeve të mësuesve, shoqëruar me diskutime interaktive nga pjesëmarrësit.
- Më datë 30 maj 2023 në ambjentet e bibliotekës së FE u organizua promovimi i librit poetik “Përbri vetes” me autore Helena Halilaj, pedagoge në QEV.
- Më datë 5 qershor 2023, u organizua “Ekspozita e lojrave” në kuadër të përfundimit të kursit Edukimi përmes lojës me studentët e programeve profesionale “Edukator për moshën 0-3 vjeç”. Studentet paraqitën punimet e krijuara prej tyre, të cilat u konkretizuan përmes ndërveprimit me fëmijë të moshave të ndryshme.
- Gjate gjithë vitit akademik 2022-2023 u zhvilluan trajnimet për mësuesit e sistemit parauniversitar të akredituara nga MAS të hartuar mbi bazën e nevojave të mësuesve. Këto trajnime u zhvilluan në ambjentet e FE në UAMD dhe online. Gjatë kësaj periudhe u trajnuan rreth 2 mijë mësues.

Qendra për Kërkim, Zhvillim dhe Ekselencë

Qendra për Kërkim, Zhvillim dhe Ekselencë (QKZHE) është njësi kryesore në Universitetin e cila ka për qëllim koordinimin e kërkimit shkencor për inovacion dhe zhvillim, në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës; nxitjen dhe mbështetjen e stafit akademik dhe komunitetit studentor për zhvillimin e kapaciteteve në kërkimin shkencor.

Qendra për Kërkim, Zhvillim dhe Ekselencë (QKZHE) ushtron aktivitetin e saj duke synuar realizimin e kërkimit shkencor si pjesë integrale e punëve të stafit akademik të UAMD-së dhe zhvillimin e bashkëpunimit me institucione dhe qendra të tjera kërkimore brenda dhe jashtë vendit, në interes të realizimit të kërkimit shkencor për inovacion e zhvillim, në përputhje me prioritetet strategjike për zhvillim demokratik e social-ekonomik të vendit.

Veprimtaria e QKZHE për vitin akademik 2022-2023

- QKZHE mori pjesë në modulën e organizuar nga EIT InfraBooster i cili promovon përdorimin efektiv të infrastrukturave kërkimore të financuara nga publiku në pronësi të universiteteve ose instituteve kërkimore. EIT InfraBooster i ofruar nga Universiteti i Varshavës është pjesë e nismës EIT InfraBooster, e krijuar për të ndihmuar të identifikohen, specifikohen, promovohen dhe menaxhohen infrastrukturat kërkimore që janë thelbësore për nxitjen e bashkëpunimit shkencë-industri. Ky program u ofrua nga ekipi i ekspertëve në Universitetin e Varshavës, të cilët janë të përkushtuar të ofrojnë një përvojë të pasur dhe tërheqëse mësimore.
- **QKZHE dhe stafi ka hapur thirrjet për punime shkencore dhe mundësuar publikimin e revistës shkencore ndërdisiplinore IJRD të UAMD-së, Vol. 10 , nr 1 (mars); Vol. 10 nr. 2 (korrik- edicion special) dhe po mbyll publikimin e Vol 10, nr 3, (nëntor) 2023.**
- QKZHE u angazhua me stafin akademik dhe aplikoi në projektin Jean Monnet Module financiar nga Komisioni Europian. Projekti rezultoi fitues për vitin 2023-2026 , ku UAMD merr pjesë me projektin -EUALB EU and Albania: Understanding democracy, communication and integration.
- **QKZHE, bashkë me grupin e punës, hartoi Planin Strategjik mbi Zhvillimin Profesional të Personelit 2023-2026 i cili ka si qëllim të realizojë zhvillimin personal, profesional, trajnimin dhe edukimin e vazhdueshëm të personelit akademik dhe administrativ të UAMD-së, si dhe konsolidimin e kulturës së të mësuarit të vazhdueshëm. Planin Strategjik mbi Zhvillimin Profesional të Personelit 2023-2026 u miratua me vendim Senati nr. 36 dt. 7.07.2023.**
- QKZHE, në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Juridike, Drejtorinë e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë, në kuadër të **Planit Strategjik mbi Zhvillimin Profesional të Personelit organizuan trajnimin e parë të stafit administrativ me temë: “Mirëfunksionimi i sekretarive të fakulteteve”** ku morën pjesë 27 persona, Zv. Dekanet për Procesin Mësimor, Kryesekretaret dhe staf i sekretarive.

Bashkëpunimi me komunitetin e qytetit

Universiteti është pjesë e qytetit dhe dëshiron të kontribuojë më shumë për komunitetin vendor. Së bashku me komunitetin e qytetit, jo vetëm që do të lidhim më mire Universitetin me tregun e punës, por edhe do të njohim trendin dhe nevojat specifike në mënyrë që të përmirësojmë kurrikulat e studimit dhe mendimit shkencor në UAMD.

UAMD ka një zyrë specifike për monitorimin dhe ndjekjen e vazhdueshme të punësimit të të diplomuarve të tij nëpërmjet Sektorit të Karrierës, Alumni dhe Komunikim (KAK). Ky monitorim kryhet duke dërguar periodikisht formularin për t'u plotësuar online nga studentët e diplomuar në adresat e tyre të e-mail përmes të cilës mbledhen informacione mbi punësimin e tyre. Duke u bazur te mbledhja dhe përpunimi i informacionit të mbledhur, rezultojnë se punësimi i studentëve të diplomuar në UAMD, jo gjithmonë përkon ose është në një linjë, me fushën për të cilën studentët kanë marrë formimin përkatës dhe janë diplomuar.

Në kuadër të bashkëpunimit me komunitetin Sektori për Karrierën dhe Alumni zhvilloi një Webinar me temë: "Përgatitja për jetëshkrimin, letrën e motivimit dhe procesin e intervistës".

Ky Webinar u zhvillua në tre faza trajnimi, përkatësisht në datat 15-17-22 Qershor 2021 dhe kishte në fokus të tij përgatitjen e jetëshkrimit, letrës së motivimit dhe kalimin me sukses të intervistës së punës. Përgjatë këtyre fazave trajnuese mbi 100 studentë mësuan mbi shkrimin e një CV-je fituese, hartimin profesional të letrës së tyre të motivimit, kalimin me sukses të një interviste pune dhe krijimin e dosjes së karrierës.

Gjithashtu në vazhdimësinë e bashkëpunimit me komunitetin u organizua për herë të parë në Universitetin "Aleksandër Moisiu" në Durrës, "Panairi i Punës dhe Karrierës".



Ndërkombëtarizimi. Marrëveshjet. Projektet. Mobiliteti.

Ndërkombëtarizimi i programeve të studimit, përmes organizimit dhe ofrimit të diplomave të përbashkëta dhe/apo të dyfishta me universitetet partnere përmes.

- Nënshkrimit të programeve të përbashkëta/dyfishta; UAMD është në komunikime të vazhdueshme me universitetet në vendet e BE-së në lidhje me nënshkrimin e marrëveshjeve për diploma të përbashkëta/të dyfishta.
- Diplomë e dyfishtë në ciklin e tretë të studimeve, Doktoratë në “E drejtë publike” me Universitetin Tor Vergata Romë, Itali;
- Diplomë e dyfishtë në ciklin e dytë të studimeve, Master i Shkencave në “E drejtë evropiane dhe e krahasuar” me Universitetin Sapienza Romë, Itali.



UAMD – 20 marrëveshje të reja ndër-institucionale këtë vit akademik nën programin Erasmus+.

Nr	Universiteti
1	Universiteti Coimbra Portugali
2	Universiteti Cadiz Spanje
3	Universiteti Bon Gjermani
4	Universiteti Pavia Itali
5	Universiteti Filozofise Nitra Slloveni
6	Universiteti Tuscìa Itali
7	Universiteti Salento Itali
8	Universiteti Siena Itali
9	Universiteti Palermo Itali
10	Universiteti West Suedi
11	Universiteti Franche-Comte France
12	Universiteti i Shkencave të Aplikuara Hanze Holande
13	Universiteti La Laguna Spanje
14	Universiteti Valencia Spanje
15	Universiteti Valahia Targoviste Rumani
16	Amigo Consortium
17	Santiago De Compostela University
18	Universiteti Trakia Bullgari

19	Universiteti Pisa Itali
20	Universiteti Valahia Targoviste Rumani



Mobiliteti i studentëve

Këtë vit, UAMD ka patur një rritje të ndjeshme të studentëve të cilët kanë përfituar nga shkëmbimet në universitetet partnere europiane.

Vetëm gjatë vitit akademik 2022-2023 nga UAMD kanë marrë pjesë në shkëmbime për në universitetet 122 studentë.

- Rritje e numrit të studentëve të huaj;

Në UAMD kanë ardhur gjatë vitit akademik 2022-2023, 5 studentë incoming nga universitetet europiane.

- Ofrimi i programeve të studimit në gjuhën angleze.

Ofrimi i programeve të studimit në gjuhën angleze. Fakultetet në UAMD, kanë ofruar aktivizimin e programeve të caktuara në gjuhën angleze nisur nga kërkesa e studentëve të huaj. Aktualisht, programet që ofrohen në gjuhë angleze pranë çdo fakulteti, janë të publikuara në faqën zyrtare web të UAMD-së. Është shtuar kërkesa nga ana e universiteteve partnere dhe studentëve të huaj për kurset në gjuhën angleze

Mobiliteti i stafit akademik

Sa i takon shkëmbimeve të stafit akademik, gjatë këtij viti, kanë përfunduar shkëmbimet 390 staf akademik dhe administrativ (staf outgoing).

- Rritje e numrit të stafit të huaj;

Në UAMD gjatë vitit akademik 2022-2023 kanë ardhur 108 staf incoming.

PARTNERITETET

Zhvillimi i bashkëpunimit dhe nxitja e partneriteteve në nivel lokal, kombëtar, ballkanik dhe ndërkombëtar

UAMD është përkushtuar në zhvillimin e bashkëpunimit dhe nxitjen e partneriteteve në nivel lokal, kombëtar, ballkanik dhe ndërkombëtar. Kjo strategji mbështet në tërësi zhvillimin e partneriteteve publik-privat, me komunitetin e biznesit, think tank, shoqëri civile dhe median. Një numër i konsiderueshëm marrëveshesh bashkëpunimi janë nënshkruar me institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. Strategjia e ndërkombëtarizimit mbështet rivitalizimin, në nivel vertikal dhe horizontal, të marrëveshjeve ekzistuese të bashkëpunimit, si edhe nënshkrim të marrëveshjeve të reja me universitete brenda dhe jashtë vendit, kryesisht ato perëndimore, me grupet e interesit për të formalizuar apo institucionalizuar marrëdhënien, për të patur një ambient favorizues dhe stimulues për kërkimin shkencor dhe për të realizuar shkëmbime të stafit akademik dhe të studentëve. UAMD synon gjithashtu nënshkrimin e marrëveshjeve të reja dypalëshe dhe shumëpalëshe të bashkëpunimit, zbatimin e tyre në praktikë, monitorimin e ecurisë së tyre, vlerësimin/matjen e progresit të arritur dhe impaktit potencial me mundësi përshkallëzimi të praktikave të mira në nivel kombëtar dhe më gjerë.

Për gjatë vitit akademik 2022-2023, janë nënshkruar **31 marrëveshje të reja** (shih tabelen 3 MOU)

Fushat e përgjithshme të marrëveshjeve të bashkëpunimit janë:

- Nxitja e bashkëpunimit për përmirësimin e punës në fusha të përbashkëta studimi dhe kërkimi, shkëmbime të botimeve akademike ose periodike, mundësia reciproke në përdorimin e bibliotekave për literaturë të pa klasifikuar, inkurajim i përdorimit të teksteve;
- Bashkëpunime në shërbim të studentëve për krijimin e mundësisë së praktikave mësimore për të integruar studimet akademike me përvojën e punës;
- Bashkëpunim dhe shkëmbime në programe ndërkombëtare të arsimit dhe kërkimit shkencor si Erasmus+;
- Shkëmbim i materialeve dhe rezultateve të punës studimore e shkencore;
- Shkëmbimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore në aktivitete didaktike, në kuadër të shkëmbimit të përvojës shkëmbehen programe dhe plane mësimore për fushat me interes të përbashkët
- Shkëmbim studentësh të cikleve të ndryshme studimi për periudha semestrale studimi ose për periudha praktike mësimore;
- Shkëmbim i stafit akademik dhe administrativ;
- Mbështetje të kërkimit shkencor të orientuar drejt praktikës;
- Nxitja dhe motivimi për punime shkencore për kualifikimin dhe marrjen e titujve akademik;
- Organizimi i konferencave të përbashkëta, trajnimeve, intershipëve, seminareve, praktikave mësimore, leksioneve të hapura kurseve specifike;

Organizim i shkollave verore për studentët; Stafi i Drejtorisë ka ofruar mbështetje në realizimin e aktiviteteve të ndryshme, është angazhuar në shpërndarjen e informacionit për rritjen e kapaciteteve njerëzore përmes pjesëmarrjes së stafit akademik në konferenca publikime kombëtare e ndërkombëtare.

Rritja e numrit dhe cilësisë së zbatimit të projekteve zhvillimore, në fushën e kërkimit shkencor, teknologjisë, inovacionit dhe transferimit të teknologjive.

UAMD është i angazhuar intensivisht në aplikimin dhe zbatimin e projekteve që lidhen me rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor dhe inovacionit për arsimin e lartë, projekte që targetojnë zhvillimin e kapaciteteve të stafit akademik, mobilitetin e pedagogëve dhe studentëve pranë universiteteve të huaja, organizimin e konferencave shkencore të përbashkëta, përkthime e botime akademike e pedagogjike nga autorë të njohur ndërkombëtarisht në bashkëpunim me stafin lokal, si dhe pajisjen e mjediseve mësimore dhe laboratorëve.

Sa i takon aplikimeve 2022-2023:


- ✓ me çeljen e fazës së re të programimit 2021-2027 nën programin Erasmus+, UAMD ka aplikuar këtë vit akademik janë aplikuar 10 projekte (4 në rolin e koordinators dhe 6 në rolin si institucion partner) koordinators për Rritjen e Kapaciteteve në Arsimin e Lartë, CBHE.
- ✓ 3 projekte Jean Monnet, Erasmus +.
- ✓ Projekt i aplikuar nën thirrjen MSCA Citizens (European Researchers' Night and Researchers at Schools 2024-2025, HORIZON 2020

NEWSLETTER

EDICIONI I-rë



Tetor 2023-Mars 2024



Top News

Aleanca STARS EU në Universitetin Franche-Comté, Besançon në Francë.
Lançimi i Konferencës Vjetore, në UAMD 2025.

Presidentit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara Hanze, Z. Dirk Johan Pouwels, i'u dorëzua Titulli i nderit "Doctor Honoris Causa"

STARS EU një histori suksesi

Në këtë edicion të parë të Newsletter-it të UAMD për STARS EU, ju ftojmë të lexoni në një udhëtim frymëzues përmes arritjeve, inovacioneve dhe historive të suksessit që kanë formuar Aleancën e Universiteteve Europiane STARS EU. Që nga krijimi i saj, STARS EU ka synuar të rrisë ndikimin e arsimit të lartë në shoqëri, duke ndërtuar një rrjet të fortë midis universiteteve partnere që ndajnë të njëjtën pasion për inovacionin, kërkimin shkencor dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

Nëpërmjet aktiviteteve të saj të shumta, që përfshijnë konferenca të rëndësishme, projekte inovative dhe iniciativa të qëndrueshme, STARS EU ka vendosur një standard të ri për bashkëpunimin akademik në Europë. Kjo Aleanca ka lejuar anëtarët e saj të shkëmbejnë ide, të ndajnë praktika të mira dhe të punojnë së bashku në projekte që synojnë të adresojnë sfidat globale dhe të ndikojnë pozitivisht në shoqëritë përreth tyre.

Në jemi krenarë të prezantojmë disa nga momentet më të spikatura të 6-të mujorit të parë, duke përfshirë ceremoninë e nderit "Doctor Honoris Causa", konferencën vjetore në Universitetin Franche-Comté Besançon në Francë, dhe nismat e suksesshme të mbjelljes së fidanëve që simbolizojnë rritjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm.





Transforming Regions. Empowering people.

Co-funded by the European Union

Nga sa më lart dhe nga rezultatet e deritanishme, kanë rezultuar fitues:

- Rritja e njohurive dhe aftësive në IAL e vendeve të Ballkanit Perëndimor drejt një transporti detar me emetim karboni 0 (Zero C)- UAMD është në rolin e liderit në këtë projekt.
- 4 projekte të financuar nga AKKSHI përmes fondeve të kërkimit shkencor
 - ✓ Eco-hotelet si nje model i pergjegjesise ambjentale dhe inovacionit ne industrine e hotelerise;
 - ✓ Emetimi i CO2 nga operatorët portuale dhe impakti i tij ne kompleksin portual Durres, Porto Romano;
 - ✓ Vleresimi i gabimeve refraktive, kariesit dhe skoliozes ne femijet e grupmoshave 6-14 vjec
 - ✓ Krijimi i nje sistemi te qendrueshem ushqimor “Nga ferma ne Tryeze”.
- 2 projekte të financuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, konkretisht:
 - ✓ Diplomë e dyfishtë në ciklin e tretë të studimeve, Doktoratë në “E Drejtë Publike” me Universitetin Tor Vergata Romë, Itali
 - ✓ Diplomë e dyfishtë në ciklin e dytë të studimeve, Master i Shkencave në “E Drejtë Evropiane dhe e Krahësuar” me Universitetin Sapienza Romë, Itali.

PROJEKTET

Për vitin akademik 2022-2023 janë financuar 21 projekte të kërkimit shkencor më poshtë:

1. E- Qeverisja – Digjitalizimi i sektorit publik dhe shërbimeve publike;
2. Rritja e qëndrueshme e mirëqenies përmes sipërmarrjeve të reja sociale: Konkurse dhe dokumentacion politikash për fizibilitetin e qasjes;
3. Impakti i mediave sociale dhe zhvillimit teknologjik në aplikimin e programeve të besnikërisë konsumatore. Rasti i tregut të shërbimeve në Shqipëri;
4. ResCLIN – Forcimi i kapaciteteve të funksionimit të Klinikës së Ligjit përmes kërkimit shkencor;
5. Ankthi profesional dhe ndikimi i tij në mësimdhënie;
6. Sfidat dhe praktikat që sjellin fuqizimin e grave në sipërmarrje dhe vendim-marrje politike: rast studimor i rajonit të Durrësit dhe Tiranës;
7. Vlerësim i turizmit dhe siteve turistike në qytetet Berat, Përmet, Kolonjë ndaj inovacionit drejt turizmit të eksperiencave;
8. Dizajnimi dhe Implementimi i Databazës së Aluminit për Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës;
9. Fuqizimi i performances së mësuesit të arsimit fillor midis dilemave dhe tendencave post-covid-19;
10. Zbatimi i Strategjisë së re të BE-së për ushqimin në zinxhirin ushqimor në Republikën e Shqipërisë;
11. Krijimi i Manualit për zhvillimin e praktikës profesionale për studentët e Fakultetit të Edukimit, cikli i parë dhe i dytë i studimeve.
12. Kërkim mbi vlerësimin e Programeve të studimit në Fakultetin e Edukimit UAMD (Programet e edukimit fillestar të mësuesve të Arsimit Fillor (BA/MA) dhe Arsimit Parashkollor);
13. Siguria kibernetike në transportin detar, element kyç për zbatimin e aktiviteteve detare portuale të sigurta dhe innovative;
14. Lidhja e kërkimit shkencor me mësimdhënien;
15. MCDA- Grupi i Analizës së Vendimit: Studim, Analizë dhe Ndihmesë në Vendimarrje në aktivitete të ndryshme ekonomike dhe probleme lokale dhe kombëtare;
16. Rritja e kapaciteteve të administratës vendore në gjetjen e burimeve të reja të financimit;
17. Procesi i Integritetit Evropian dhe roli i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;
18. Qytetari e angazhuar në Bashkinë Durrës për shërbimin “Administrim të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”;
19. Ulja e Borxhit publik, nga legjislacioni i zbatueshëm me strategjinë afatmesme të menaxhimit të riskut (SAMB / AFMIS);
20. Përforcimi i legjislacionit të MFK-së, përmes shtimit të kontrollit të brendshëm të menaxhimit financiar e kontrollit (KR);

21. Sfidat e politikave publike në administratën publike shqiptare.

Rritja e vizibilitetit të universitetit, përmes rrjetëzimit në rrjetet universitare në rajonin e Ballkanit perëndimor, rajonit të mesdheut dhe vendeve anëtare të OSCE-së.

UAMD synon të jetë i pranishëm aktivisht në aktivitete ndërkombëtare shkencore dhe botuese. Si rezultat i kontakteve të krijuara nga lëvizjet e studentëve e akademikëve dhe nga përafrimi i kurrikulave, i cili është i nevojshëm në rastin e shkëmbimit të studentëve, stafet akademike do të mund të rrisin kapacitetet lidhur me edukimin që ofrohet në UAMD. Këto aktivitete do të kontribuojnë në përshtatjen dhe përhapjen e “praktikave të mira” si edhe në cilësinë e edukimit dhe të trajnimit. Drejtoria ka mbajtur komunikime të vazhdueshme dhe ka qënë pjesëmarrëse aktive në aktivitetet e rrjeteve ku është anëtare si UNIMED, AUF, OARI etj

- Aleanca Strategjike për Tranzicionin Rajonal - STARS European University.

Që nga viti 2022, UAMD është pjesë e Aleancës Universitare Evropiane “Aleanca Strategjike për Tranzicion Rajonal” – STARS EU – www.starseu.org dhe ka fituar financim për një projekt prej 14M EUR në nivel aleance që përfshin tetë Universitete të tjera Evropiane;

Ndërkohë, ka vijuar procesi për zbatimin dhe ndjekjen e projekteve që po zbatohen aktualisht në UAMD konkretisht për projektet: ENTRAL, QUADIC, KALCEA, STAND, IDEA, ENGINE, USIA, MEPM, TTO4FOOD, MAGNET, PELMOB, WEBJOU, IoT-ECO, Interreg (CRESCENDO) ku UAMD është institucion partner.

RESURSET E INSTITUCIONIT

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

UAMD përmbush plotësisht detyrimet ligjore për plotësimin e njësive bazë me staf akademik me grada e tituj. Institucioni publikon në faqen zyrtare të internetit organigramën. Ai ndjek procedurë transparente të rekrutimit të stafit akademik dhe jo akademik në përputhje me Rregulloren (nenet 26, 27, 28) dhe Statutin e Universitetit (neni 33), dhe të akteve të tjera nënligjore.

Personeli akademik i UAMD klasifikohet në 3 kategori : Profesorë, Lektorë dhe Asistent-lektorë. Duhet theksuar se në rastet e stafit akademik efektiv që nuk kanë fituar gradën Dr. vetë institucioni i ka mundësuar trajnime efektive pranë Qendrës për Edukim në Vazhdim. Në rekrutimin e stafit akademik me kontratë vihet re një rritje e profesionalizmit të kandidatëve që tregon dhe reputacionin e mirë që Institucioni ka krijuar .Vlen për të përmendur gjithashtu një ulje në raportin staf akademik-studentë përm2. Ky reduktim vjen si pasojë e rritjes së numrit të stafit akademik, por edhe aktivizimit të godinës së re në Kampusin e Universitetit. Për vitin akademik 2022-2023, rezultojnë të punësuar për të dy semestrat përkatësisht, 313 personel akademik me kohë të plotë dhe 310 personel akademik me kohë të pjesshme.

Aktualisht UAMD ka 313 të punësuar si personel akademik nga të cilët 74 të kategorisë Asistent Lektorë, 173 Lektorë dhe 55 Profesorë i Asociuar dhe 11 Profesor Doktor. Personeli akademik i kategorisë asistent lektor janë të punësuar me kontratë me afat të caktuar, personeli akademik i kategorive lektor dhe profesor janë të punësuar me kontratë pa afat.UAMD ka të punësuar personel ndihmës-akademik me karakter teknik (laborantë) 12 persona, personel administrativ me karakter ndihmës-akademik 52persona dhe personel administrativ më shumë se 105 persona.UAMD ndjek një politikë integruese dhe ndërkombëtarizuese për personelin dhe studentët e tij. Personeli akademik dhe administrativ ka qenë pjesë e shkëmbimeve të komponentit të mobiliteteve duke sjellë në institucion përfitime profesionale dhe duke zgjeruar rrjetin e bashkëpunimeve si rrjedhojë e këtyre mobiliteteve, numri i stafit akademik që ëshërë angazhuar në projektet e financuara nga BE (ERASMUS+) është (124) dhe implementimi i mobiliteteve ka filluar në 2021. Risi është gjithashtu krijimi i një mekanizmi vlerësimi të vazhdueshëm e periodik për personelin në përputhje me rregulloren e UAMD, mekanizëm ky i organizuar në tre nivele të cilat përfshihen në Raportin Vjetor të Vlerësimit.

Studentët gjithashtu janë pjesë e vlerësimit të personelit akademik. Çdo vit studentëve iu shpërndahen pyetësorë nga Drejtoria e Kurrikulave dhe Standardeve të Cilësisë, lidhur me performancën e personelit akademik. Pyetësorët plotësohen në mungesë të personelit akademik dhe ruajnë anonimatit e studentit. Rezultatet e anketimit nga studentët pasqyrohen në Raportin e Performancës së Personelit Akademik.

KURRIKULA

Programet e studimit të ofruara nga UAMD janë në përputhje me misionin e UAMD , si dhe në përputhje me misionin e Njësive Kryesore ku ofrohen këto programe studimi të pasqyruar në rregulloret e brendshme të këtyre njësive. Përputhja e programeve të studimit me misionin e Njësive Kryesore të UAMD-së kontrollohet që në aplikimin e hapjes së programit të studimit, fillimisht nga Njësitë Bazë dhe ato Kryesore dhe më pas nga Senati Akademik. Kapacitetet infrastrukturore verifikohen çdo fillim viti akademik nga Ministria përgjegjëse për Arsimin gjatë miratimit të kuotave për çdo program studimi. Gjithashtu këto kërkesa monitorohen në mënyrë të vazhdueshme edhe nga komisioni i përhershëm për garantimin e standarteve dhe cilësisë.

UAMD siguron informim publik të ofertës akademike nëpërmjet zyrave përgjegjëse dhe paraqitet në mënyrë të përditësuar në faqen zyrtare.

Aktualisht bazuar në riorganizimin hapjen dhe mbylljen e programeve të studimit të azhurnuar në vitin akademik 2022-2023, UAMD ofron 97 programe studimi. Në UAMD aktualisht ofrohen 18 programe me karakter profesional (2 vjeçar), 34 programe të ciklit të parë bachelor, 45 programe të ciklit të dytë (27 profesional dhe 18 shkencor), 1 Diplomë e Integruar e nivelit të Dytë Master i Shkencave në “Drejtësi”, 3 programe të ciklit të tretë të studimeve “Doktoratë”, specifikisht 1 program i ciklit të tretë, Doktoratë në FB 1 program i ciklit të tretë, Doktoratë në FSHPJ dhe pranë 1 program i ciklit të tretë, Doktoratë në FE. UAMD mundëson që programet e studimit të ciklit të dytë të ndiqen edhe nga studentë që janë në marrëdhënie pune. Për këtë objektiv janë krijuar kushtet e duhura infrastrukturore dhe kohore që studentët e programeve të ciklit të dytë ti frekuentojnë këto programe në orare të përshtatshme që i mundësojnë vazhdimin e marrëdhënies së punës gjatë kohëzgjatjes së studimeve.

Risi në vitin akademik 2022-2023 janë diplomat e dyfishta.

Çfarë do të thotë diplomë e dyfishtë?

Diplomat e dyfishta janë diploma që parashikohen në Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Këto diploma organizohen në bazë të marrëveshjeve që nënshkruajnë dy insitucione të arsimit të lartë, ku programi për të cilin bien dakort organizohet në mënyrë analoge, si lëndët përkatëse, organizimi i krediteve ECTS, mbrojtja e diplomës.

Ky program studimi është aprovuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe sipas ligjit në përfundim të këtij programi studentët përfitojnë dy diploma përkatësisht nga Universiteti i Genovës dhe Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës.

Kjo diplomë u jep mundësinë studentëve të punojnë në:

1. Organizata ndërqeveritare;
2. Adminsitratën publike qendrore apo lokale, sidomos në sektorin e marrëdhënieve me jashtë dhe projekteve të financuar nga donatorë të huaj;
3. Shërbimet diplomatike në vend dhe jashtë vendit;
4. Organet e Bashkimit Evropian, të ndodhura në zyrat qendrore apo në vende të tjera anëtare;
5. Organizata jo qeveritare kombëtare dhe ndërkombëtare;
6. Struktura turistike ku marrëdhëniet ndërkombëtare janë thelbësore.
7. Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
8. Diplomë e Dyfishtë me Universitetin Sapienza, të Romës.(Bachelor)

⁷Studime të tregut të punës në dosjet e riorganizimit ose në dosjet e reja të studimit.

Në Universitetin Aleksandër Moisiu, Durrës, ofrohen 4 programe studimi diploma e dyfishtë:

1. Shkenca Ndërkombëtare dhe Diplomatike “Diplomë e dyfishtë me Universitetin e “Genovas”, Itali. (Bachelor)”
2. E Drejtë Evropiane dhe e Krahasuar “Diplomë e Dyfishtë me Universitetin “Sapienza”, të Romës.
(Master i Shkencave)
3. Administrim Publik “Diplomë e dyfishtë me Universitetin e “Côte d’Azur”, Francë. (Master i Shkencave)”
4. E Drejtë Publike “Diplomë e dyfishtë me Universitetin e “Tor Vergatas”, Itali. (Doktoraturë)”

Cilësia dhe fleksibiliteti i Kurrikulës

- Mundësimi dhe sigurimi për një përgatitje e formim cilësor teorik dhe praktik në përputhje me kërkesat e tregut.
- Organizimi i programeve të studimit me objektiva të përcaktuara qartë, bën të mundur që ato të jene lehtësisht të kuptueshme dhe të arritshme.
- Ngarkesa mësimore e stafit akademik bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet nënligjore në fuqi.
- Vlerësimi dhe zhvillimi i politikave mbështetëse nga institucioni për ecurinë dhe mbarëvajtjen e studentëve.
- Organizimi i programeve akademike u mundëson studentëve të praktikojnë aftësitë teorike dhe të përgatiten për të qenë të aftë në tregun e punës.
- Mundësimi i vlerësimit cilësor të dijeve teorike dhe praktike të studentëve, nëpërmjet provimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare dhe vlerësimi i praktikave të zhvilluara përgjatë fazave të kontrollit të dijeve, sipas një sistemi unik i ndërtuar dhe bazuar në eksperiencën e universiteteve amerikane.
- Cilësia e programeve të studimit dhe aplikimi që në hapje e Kartës së Bolonjës për mobilitetin e pedagogëve dhe studentëve, ka mundësuar ndër vite që shumica e ish studentëve të UAMD, të ushtrjnë profesionin dhe të japin kontributin e tyre në institucion, duke qenë pjese e stafit akademik të Fakulteteve të Universitetit, si edhe ne universitetet e tjera brenda vendit, ose të punojnë në institucione e kompani te ndryshme.



- Përdorimi i metodave interaktive dhe efektive, orientimi drejt risive dhe inovacionit në mësimdhënie e kërkimin shkencor, ka mundësuar krijimin e një qasje ndaj studenteve, duke i ndihmuar në mësimnxënie, në kuptimin konceptual të situatave komplekse me karakter ekonomik dhe jo vetëm, krijimin e aftësive krijuese për të gjeneruar ide të reja mbi teoritë, produktet, njohuritë etj.

-Studimi i tregut nga departamentet e fakulteteve të Universitetit, mundëson hapjen e programeve të reja të studimit, ashtu si dhe riorganizimin e atyre ekzistuese, për një përshtatje më të mirë ndaj kërkesave të tregut, si dhe do të ndikojë pozitivisht në preferencat e studentëve të të dy cikleve të para të studimit.

Të gjitha kurrikulat e UAMD për çdo cikël studimi mund të aksesohen në faqen web të Institucionit ose duke skanuar kodin në këtë faqe.




MËSIMDHËNIA DHE KËRKIMI SHKENCOR

Gjatë vitit akademik 2022–2023, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës vijoi të zhvillojë veprimtarinë kërkimore-shkencore në përputhje me misionin institucional, objektivat strategjikë të universitetit dhe kuadrin ligjor në fuqi. Kërkimi shkencor u konsiderua një komponent thelbësor i procesit të mësimdhënies, zhvillimit akademik dhe sigurimit të cilësisë, duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve kërkimore, ndërkombëtarizimin e universitetit dhe përmirësimin e vazhdueshëm të performancës institucionale.

Politikat institucionale gjatë këtij viti akademik u orientuan drejt nxitjes së kërkimit cilësor, promovimit të publikimeve në revista shkencore të indeksuara, zgjerimit të pjesëmarrjes në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe rritjes së angazhimit të personelit akademik në projekte kërkimore dhe bashkëpunime me institucione të arsimit të lartë dhe organizata partnere. Këto politika u mbështetën në monitorimin sistematik të treguesve të performancës kërkimore dhe në analizën periodike të rezultateve të arritura.

Në funksion të përmirësimit të cilësisë së kërkimit shkencor, universiteti vijoi të përdorë mekanizma të vlerësimit të bazuar në tregues bibliometrikë, publikime shkencore, citime, pjesëmarrje në konferenca dhe përfshirje në projekte kërkimore. Këta tregues shërbyen për të evidentuar progresin institucional dhe për të orientuar prioritetet e zhvillimit në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë.



Analiza e të dhënave institucionale evidencon se gjatë vitit akademik 2022–2023 është ruajtur një ritëm i qëndrueshëm i aktivitetit kërkimor në të gjitha njësitë akademike të universitetit. Personeli akademik ka vijuar të kontribuojë në botimin e artikujve shkencorë në revista kombëtare dhe ndërkombëtare, përfshirë revista të indeksuara në databaza të njohura ndërkombëtare, si dhe në prezantimin e punimeve në konferenca shkencore.

Veprimtaria botuese ka qenë një nga treguesit kryesorë të performancës institucionale. Publikimet shkencore pasqyrojnë angazhimin e vazhdueshëm të stafit akademik në zhvillimin e kërkimit dhe në rritjen e ndikimit të rezultateve shkencore. Krahas botimeve në revista të indeksuara, është evidentuar edhe pjesëmarrja në botime kolektive, kapituj librash dhe materiale konferencash, duke kontribuar në zgjerimin e aktivitetit akademik të universitetit.

Monitorimi i treguesve bibliometrikë tregon një përmirësim gradual të ndikimit shkencor të universitetit. Rritja e numrit të citimeve dhe publikimeve të indeksuara dëshmon për një orientim të qëndrueshëm drejt rritjes së cilësisë së kërkimit dhe të dukshmërisë ndërkombëtare të rezultateve të prodhuara nga stafi akademik.

Njëkohësisht, gjatë vitit akademik u vu re një angazhim i konsiderueshëm në organizimin dhe

pjesëmarrjen në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, seminare, forume akademike dhe aktivitete ndërdisiplinore. Këto aktivitete krijuan mundësi për shkëmbimin e përvojave, prezantimin e rezultateve të kërkimit dhe krijimin e bashkëpunimeve të reja akademike.

Ndërkombëtarizimi mbeti një ndër prioritetet strategjike të universitetit edhe gjatë vitit akademik 2022–2023. Në këtë kuadër, u vijua pjesëmarrja në programe mobiliteti, projekte kërkimore dhe iniciativa të financuara nga partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Pjesëmarrja në programe si Erasmus+ dhe iniciativa të tjera bashkëpunimi ka kontribuar në shkëmbimin e përvojave akademike, zhvillimin profesional të stafit dhe përmirësimin e kapaciteteve institucionale në fushën e kërkimit shkencor. Përmes këtyre bashkëpunimeve janë krijuar mundësi për zhvillimin e projekteve të përbashkëta, publikimeve me bashkautorësi dhe pjesëmarrjen në rrjete ndërkombëtare kërkimore.

Bashkëpunimi me universitete dhe institucione të tjera kërkimore ka ndikuar pozitivisht në rritjen e cilësisë së veprimtarisë shkencore dhe në promovimin e praktikave bashkëkohore të kërkimit. Këto partneritete kanë forcuar dimensionin ndërkombëtar të universitetit dhe kanë krijuar mundësi të reja për zhvillimin e aktiviteteve akademike dhe shkencore.



Një element i rëndësishëm i politikave institucionale ishte integrimi i kërkimit shkencor me procesin e mësimdhënies. Aktiviteti kërkimor nuk u zhvillua vetëm si pjesë e punës individuale të personelit akademik, por edhe si komponent i formimit universitar.

Studentët e ciklit të dytë dhe të tretë u përfshinë në konferenca shkencore, seminare, projekte kërkimore dhe aktivitete akademike, duke zhvilluar aftësi në metodologjinë e kërkimit, analizën shkencore dhe prezantimin e rezultateve. Kjo qasje ka kontribuar në forcimin e lidhjes ndërmjet mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke krijuar një mjedis akademik që mbështet zhvillimin e kompetencave profesionale dhe shkencore të studentëve.

Një rol të rëndësishëm në promovimin e rezultateve të kërkimit vazhdoi të luajë revista institucionale **Interdisciplinary Journal of Research and Development (IJRD)**, e cila shërben si platformë për publikimin e punimeve shkencore të personelit akademik dhe studiuesve bashkëpunëtorë, duke rritur dukshmërinë dhe impaktin e kërkimit të zhvilluar në universitet.

Analiza e përgjithshme e treguesve të veprimtarisë kërkimore për vitin akademik 2022–2023 evidenton një konsolidim të kulturës së kërkimit shkencor në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës. Rritja e angazhimit të personelit akademik në publikime, konferenca dhe projekte kërkimore, së bashku me zgjerimin e bashkëpunimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, dëshmon për përparimin e universitetit drejt përmbushjes së objektivave strategjike në fushën e kërkimit.

Megjithatë, analiza evidenton gjithashtu nevojën për vijimin e politikave institucionale që synojnë rritjen e numrit të publikimeve në revista me faktor ndikimi, zgjerimin e pjesëmarrjes në projekte

konkurruese ndërkombëtare, përmirësimin e treguesve bibliometrikë dhe forcimin e grupeve kërkimore ndërdisiplinore.

Në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të kërkimit shkencor, universiteti synon të intensifikojë mbështetjen për personelin akademik në procesin e aplikimit për projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, të forcojë bashkëpunimin me partnerët strategjikë dhe të nxisë transferimin e njohurive drejt shoqërisë dhe tregut të punës. Njëkohësisht, do të vijojë puna për zgjerimin e pjesëmarrjes së studentëve në aktivitetin kërkimor dhe për rritjen e ndikimit të rezultateve shkencore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në tërësi, rezultatet e vitit akademik 2022–2023 tregojnë se Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës ka vijuar të konsolidojë kapacitetet e tij kërkimore dhe të forcojë pozicionin e tij si institucion i arsimit të lartë i orientuar drejt cilësisë, inovacionit dhe ndërkombëtarizimit.

Treguesit e aktivitetit shkencor	FSP	FB	FTI	FE	FSHPJ	Totali UAMD
Artikuj shkencorë (Google Scholar)	427	51	86	134	151	849
Publikime në revista ndërkombëtare	37	48	21	28	18	152
Publikime në Scopus	12	39	14	11	8	84
Publikime në revista kombëtare	9	3	5	7	6	30
Pjesëmarrje në konferenca shkencore	44	121	35	42	39	281
Konferenca të organizuara	2	2	2	1	1	6
Citime (Google Scholar)	807	392	264	458	236	2,157
H-index (mesatar i fakultetit)	2	5	4	5	3	—

STUDENTËT

Njësitë bazë në UAMD janë përgjegjëse për procesin e pranimit të studentëve. Këto të fundit në mënyrë unanime, përcaktojnë kriteret e pranimit të studentëve të rinj për çdo vit akademik. Bazuar në nenin 74 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e artë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, kriteret e pranimit për vitin akademik 2021-2022 për ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, u miratuan sipas propozimeve të departamenteve në fakultete të përkatëse.

Kriteret e miratuara nga Senati akademik, publikohen në faqen zyrtare të UAMD, dhe i prezantohen komunitetit të maturantëve sipas një kalendari të informimit në institucionet e arsimit të mesëm të lartë.



Karriera dhe Alumni

Sektori i dhe Karrierës dhe Alumnit është struktura përgjegjëse që zhvillon dhe drejton procesin e këshillimit të karrierës, ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierës profesionale të studentëve, mban kontakte me të diplomuarit (Alumni), krijon mundësi bashkëpunimi me kompani për mundësi praktikash dhe punësimi për studentët/alumnit, organizon aktivitete për studentët me fokus karrierën të tilla si: trajnime, seminare, workshop-e etj. Sektori i dhe Karrierës dhe Alumnit mundëson:

- ✓ Ofrimin e këshillimit dhe udhëzimeve në lidhje me orientimin dhe zhvillimin e karrierës profesionale të studentëve në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës;
- ✓ Organizimin dhe koordinimin e aktiviteteve për studentët të tilla si: trajnime, seminare, konferenca studentore, orë leksioni të hapura nga lektorë të ftuar me fokus karrierën;
- ✓ Kontaktet dhe grumbullimin e informacioneve mbi punësimin e Alumnit;
- ✓ Hartimin e Guidës Studentore dhe Udhëzuesit të Karrierës;
- ✓ Organizimin e Panairit të Punës dhe Karrierës;
- ✓ Njoftimin e studentëve dhe alumnit mbi mundësi punësimi dhe internship etj.

Me qëllim diversifikimin e shërbimeve të karrierës që i ofrohen studentëve dhe Alumnit, UAMD ka marrëveshje bashkëpunimi me RISI Albania, një projekt i Agjencisë Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC, në fushën e orientimit dhe këshillimit të karrierës. Më 11 Nëntor 2022, u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit mes UAMD dhe RISI, ku u riafirmua angazhimi për të konsoliduar shërbimet e ofruara nga Sektori i dhe Karrierës dhe Alumnit. Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Sektori i Karrierës dhe Alumnit dhe RISI Albania kanë hartuar “Udhëzuesin e Karrierës” i cili është i aksesueshëm nga studentët përmes ëebfaqes së UAMD-së si dhe në kopje.

Për studentët që rregjistrohen për herë të parë në vit të parë në UAMD, stafi i Sektorit të Karrierës dhe Alumnit në veçanti, janë pjesë e “këndit të informacionit” në të tre godinat universitare, për t’i ndihmuar ata dhe për t’i orientuar rreth procesit të regjistrimit përgjatë dy raundeve.

Për studentët e UAMD ofrohen trajnime dhe seminare mbi hartimin e CV, Letrës së Motivimit dhe përgatitjes për Intervistë nga stafi i Zyrës së Karrierës. Në vitin akademik 2022-2023, janë realizuar gjithsej 17 trajnime ku kanë qenë pjesëmarrës rreth 190 studentë (shiko Tabelën nr. 1).

Veç trajnimeve të zhvilluara nga Zyra e Karrierës, kjo e fundit organizon për studentët edhe aktivitete me fokus karrierën, me lektorë të ftuar (guest speakers), shqiptarë ose të huaj. Disa prej aktiviteteve kryesore të organizuara në vitin akademik 2022-2023 janë si më poshtë:


- Explore Deloitte - prezantim i Deloitte Albania, mundësitë e punësimit dhe internshipit për studentët dhe alumni, programi Brand Ambassador, ofrimi i këshillimit ndaj studentëve për të ardhmen e tyre profesionale;

- Career Coaching – Seminaret e karrierës nga z. Antonio Pecorella, menaxher i burimeve njerëzore pranë MAS NET sh.p.k, Kompani që operon në fushën e shitjeve dhe shërbimeve të telekomunikacionit;
- Sesion informues nga GIZ Albania – Informim i studentëve mbi trajnimin e ofruar në fushën e hoteleri-turizmit dhe mbi mundësi punësimi sezonale në Gjermani;
- Trajnim mbi platformën “Panairi Online” – ky trajnim konsistoi në njohjen e studentëve me mënyrën e përdorimit të programit që lehtëson kërkimin online të punës ose praktikave profesionale;
- Seminari mbi Planifikimin e Karrierës – Seminar me lektorë amerikanë znj. Delores Mincarell dhe z. Terry Cole nga Global Leadership Partners, mbi identifikimin e qëllimeve dhe synimeve të karrierës dhe fazat në të cilat kalon planifikimi i karrierës;
- Trajnim nga “Super Youth” - Trajnim për studentët nga projekti “Super Youth”, mbështetur nga Ministri I Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe nga Agjencia Kombëtare e Rinisë AKR, me temë: këshillimin e karrierës dhe fazat e menaxhimit të karrierës, aftësitë e buta, aftësitë negociuese dhe komunikimii si edhe kanalet e punësimit jotradicional;
- Prezantimi i Programit Kombëtar të Praktikave të Punës – takim informues nga përfaqësues të AKR për studentët dhe alumni mbi Thirrjen nr. 8 të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, me qëllim aplikimin për të kryer praktikën profesionale në Institucione të administratës shtetërore, Njësi të vetëqeverisjes vendore, Shoqëri tregtare dhe OJF;
- Workshop online nga Graphite srl – Workshop me fokus informimin e studentëve dhe alumnit mbi punësimin në fushën e IT dhe Telemarketingut.

Sektori i Karrierës dhe Alumit ka bashkëpunim me Kompani të ndryshme mbi mundësimin e ofrimit të praktikave profesionale dhe punësimit për studentët dhe alumnit. Gjatë vitit akademik 2022-2023, Zyra e Karrierës ka bashkëpunuar me rreth 20 kompani si më poshtë:

1. Inno Data
2. Mas Net Shpk
3. Otp Bank Albania
4. Raiffeisen Bank Albania
5. B & R Studio Kontabiliteti
6. Pronatyra Treg
7. Conad
8. Megatek
9. Boost Outsourcing Solutions
10. Rgh - Revo Hospitality Group
11. Rea`s Shpk
12. Keno Audit & Consulting
13. Giobert Albania Shpk
14. Job In Albania
15. Studio Kontabel Saimir Zalla

16. Graphite Srl
17. Hitweb/Hitjob
18. Redon Consulting
19. Dekoll Shpk
20. Qendra Opportunity Durres



U organizua për të tretin vit rradhazi në Universitetin “Aleksandër Moisiu” në Durrës, “Panairi i Punës dhe Karrierës”. Ky panair u zhvillua me datë 25 Maj 2023, në të cilin morën pjesë rreth 150 biznese nga Durrësi e më gjerë. Në këtë event ishin pjesëmarrës qindra studentë, të cilët për disa orë me radhë vizituan standat e institucioneve shtetërore, sipërmarrjeve dhe organizatave të ndryshme. Zhvillimi i këtij panairi është një mundësi e vyer për të gjithë studentët pjesëmarrës, për t’u njohur më nga afër me mundësitë e ofruara për praktika profesionale dhe punësim. Ky Panair u shoqërua edhe me aktivitete të tjera si “Start-Up”, “Mbill një pemë” dhe Forumi ekonomik me temë: “Ndërkombëtarizimi i tregut të punës dhe ndikimi në ekonominë shqiptare”.

Alumnit e Programeve të studimit të Departamentit të Psikologjisë, Fakulteti i Edukimit në UAMD, me ftesë të drejtueses së Departamentit të Psikologjisë dhe me bashkëpunimin e Sektorit të Karrierës dhe Alumnit, u mblodhën më datë 11.04.2023 në ambientet e Fakultetit të Edukimit, në Zyrën e Karrierës dhe në hollin e Kampusit Universitar, në një takim Alumni me studentët e programeve Bachelor "Psikologji", studentët e Masterit Shkencor " Mësues i Shkencave Sociale" dhe Master Profesional "Psikologji Shkollore dhe Zhvillimore". Ata treguan rrugëtimin e tyre në UAMD, Fakultetin e Edukimit, zgjedhjen e dëshiruar të programeve të studimit pranë Departamentit të Psikologjisë si dhe sfidat e tregut të punës. Arritjet e tyre janë binom i bukur i përkushtimit të tyre, kurrikulave bashkëkohore si dhe punës së suksesshme të

stafit

akademik.

Takimi Alumni, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Psikologjisë



Disa të dhëna statistikore rreth shërbimeve të ofruara nga Zyra e Karrierës për vitin akademik 2022-2023

	Shërbime karriere:	Numri i pjesëmarrësve
1	Keshillime individuale	37
2	Aktivitete me fokus karrieren	450
3	Trajnime per studentet (CV/ LM/Intervista)	190

	Ndermjetesime per punesim	Numri
1	Biznese te reja me te cilet kemi krijuar bashkepunim	20
2	Studente qe jane njoftuar mbi mundesi punesimi	4000+

	Outreach	Numri i perfituesve te sherbimit
1	Këshillim individual online (e-mail, rrjete sociale, WhatsApp) nga stafi	2000+
2	Orientim dhe keshillim i studenteve te rinj qe u rregjistruan ne vit te pare	1000+
3	Gjurmim i Alumnit mbi punesimin	1500+

Tabela nr 1



(Dita Botërore e Lirisë së Shtypit)

Klubet studentore në UAMD kanë si qëllim forcimin e kapaciteteve dhe promovimin e përfshirjes dhe angazhimit të studentëve në jetën universitare. Për këtë UAMD organizon aktivitete që ndihmojnë studentët të menaxhojnë më mirë jetën studentore dhe ndërveprojnë me njëri-tjetrin për të arritur qëllime të përbashkëta.



- Klubi i Librit
- Klubi i Artit
- Klubi i Debatit
- Klubi i Multimedias dhe Fotografisë
- StartUp UAMD
- Klubi për Shoqëri të Ndjeshme

- Klubi i Juristëve të Rinj
- Klubi Diplomatik
- Klubi i Teknologjisë dhe Inovacionit
- Sustainability Club
- Klubi i Shahut

Klubet Sportive:

- Ekipi i Futbollit
- Ekipi i Basketbollit
- Ekipi i Futsalit
- Ekipi i Volejbollit Meshkuj/Femra
- Pingpong



Liridona Rexhaj, Alumni UAMD dhe kampione ne sportin e ping-pongut